

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik me karakter mësimor në pozicionin “Laborant” në Departamentin e Konstruksioneve të Ndërtimit dhe Infrastrukturës së Transportit, në lëndën “Shkenca dhe Teknologjia e Materialeve” duhet të plotësoj kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të jetë i diplomuar në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin Politeknik të Tiranës ose në fakultete të huaja analoge, në degën Inxhinieri Ndërtimi, (Diplomë Master Shkencor ose Diplomë e Ciklit 5-vjeçar).
2. Të ketë njohuri të mira të programeve kompjuterike si Autocad, paketa Office etj.
3. Të ketë eksperiencë të dokumentuar për zhvillimin e provave laboratorike.
4. Të ketë certifikatë për “Specialist i Lartë për Testimin e Performancës së Produkteve të Ndërtimit”.
5. Të ketë dëshmi së paku të një prej gjuhëve të huaja anglisht, frëngjisht, italisht dhe gjermanisht.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Referenca që lidhen me eksperiencën për zhvillimin e provave laboratorike;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **22.10.2025** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.